

ONOMASTIKA DHE RËNDËSIA E ZHVILLIMIT TË SAJ

DHIMITRI BELLO

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

E mail: dhimbello@yahoo.com

Përmbledhje

Onomastika në përgjithësi dhe toponimia në veçanti, për çdo gjuhë, përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mire mungesën e dokumenteve të shkruara. Ajo mbetet "arkivi gojor" i historisë dhe lashtësisë së kulturës të çdo kombi. Ndër hulumtimet e para rreth lashtësisë e të gjuhës shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë të parët tanë. Si fillim kemi studiuesit e huaj si Majer, Jokli, Kreçmer, Nopça etj, të cilët i janë referuar gjerë studimeve onomastike për të provuar origjinën e shqipes, për të kaluar më pas tek rilindësit shqiptarë.

Edhe pse janë bërë këto që përmendëm, sot studimet në fushën e onomastikës në nivel rajonal por edhe më gjerë lenë shumë për të dëshiruar. Në disa raste kur janë bërë, në pjesën dërrmuese mungon një analizë e plotë gjuhësore e shtrirë në rrafshin sinkronik dhe atë diakronik. Për fat të keq kemi edhe analiza të toponimisë, që jo vetëm janë larg të qenit gjuhësore, por në mjaft raste aspak objektive dhe qesharake, duke u rrekur të trajtojnë periudha historike të panjohura për ta, që shpeshherë kanë zgjuar debate të kota dhe pa fryt. Në trajtesën tonë do të mundohemi të shtjellojmë një pjesë të tyre, duke e ilustruar atë edhe me fakte historike dhe gjuhësore.

Fjalë çelës: onomastikë, toponimi, sinkroni, diakroni, analizë gjuhësore, fakte historike.

Hyrje. Onomastika është pjesë e rëndësishme e leksikologjisë, që merret me kuptimin, prejardhjen dhe shtrirjen e emrave të përveçëm si: emrat vetjakë, nofkat dhe pseudonimet (antroponimet), emrat familjarë ose siç i quajmë ndryshe edhe mbiemra (patronimet) që përbëjnë dhe njërën nëndarje si dhe emërtimet e vendeve dhe objekteve gjeografike (toponimet), që përbëjnë edhe nëndarjen tjetër të onomastikës që në vetvete këto kanë nëndarje të tjera. Onomastika për çdo gjuhë përbën një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mire mungesën e dokumenteve të shkruara. Ajo mbetet

"arkivi gojor" i historisë dhe lashtësisë së kulturës të çdo kombi. Është një shkencë sa interesante aq edhe e rëndësishme, që jep mundësi për shqyrtime të ndërlydhura e ndërdisiplinore, që mund të na çojnë në përfundime me vlerë. Kjo sidomos për shqipen merr një rëndësi të dorës së parë, duke pasur parasysh faktin e një gjuhe të vjetër, ndoshta më e vjetra në Ballkan, por me një dokumentim shkrimi të vonë. Ajo mbetet një mbështetje e fortë për argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre, si dhe për të provuar vijimësinë në përputhje me rregullat fonetike dhe gramatikore të shqipes në mjaft antroponime dhe toponime shqiptare qysh prej ilirishtes e deri tek shqipja e sotme si tek antroponimet *Bardhyl, Dashi, Artan, Neritan, Enkelejda, Brikena* etj., si dhe toponimeve *Dalmatia, Dardania, Ulqin, Vendum, Dimallum* etj. Ndër hulumtimet e para rreth lashtësisë e të gjuhës shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë të parët tanë. Materiali i parë onomastik fillimisht është futur në përdorim nga rilindësit shqiptarë, por i paargumentuar shkencërisht. Fillesat i kemi me studiuesit e huaj si Majer, Jokli, Kreçmer, Hahn, Nopça etj, të cilët i janë referuar gjerë studimeve onomastike për të provuar origjinën e shqipes, për të kaluar më pas tek studiuesit shqiptarë, që janë të shumtë në numër, nga të gjitha trevat shqipfolëse.

Antroponimia.

Antroponimia, pavarësisht se ka një rol të veçantë në historinë e një gjuhe, në vendin tonë kjo del paksa e cunguar pasi jetëgjatësia e këtyre emërtimeve nuk depërton kaq thellë, deri në gjenezë të saj. Antroponimet janë emra të përveçëm si shenjë dallimi social të individit, dhe mbart simbolikën e religjionit dhe etnisë përkatëse. Por kjo në vendin tonë është diçka e veçantë. Jetëgjatësia e këtyre antroponimeve ka qenë e lidhur ngushtë me faktorë të ndryshëm historiko- kulturorë që e kanë shoqëruar gjuhën. Nëse i referohemi antroponimeve nga dëshmi të kohëve të

lashta e deri në ditët tona, korpusi i tyre arin në mijëra njësi (Daka, 1982). Por duhet të kemi parasysh se një pjesë e tyre janë e burimit vendas, ndërsa pjesa dërmuese e përbëjnë emra të burimit të huaj, që mund të jenë pasojë e kontakteve të vjetra të shqipes, por edhe kontakteve të reja të saj duke filluar nga ato greke, romake, sllave, turko- orientale, hebraike, italiane, franceze, gjermane, spanjolle, ruse e duke përfunduar me ato anglo- amerikane. Emrat që përdoren sot, ato të dokumentuara ilire janë të paktash si: *Bardhyl, Dashi* etj. Ndërsa emërtimet e reja të burimit ilir si: *Artan, Altin, Neritan, Enkeleja, Brikena* janë si pasojë e publikimeve nga zbulimet arkeologjike të vendbanimeve ilire në vitet '60 të shekullit të shekullit të kaluar "si kërkesë e njerëzve që t'u përgjigjen bindjeve të reja" (Shkurtaj, 2001). Emri duke mbartur në vetvete në radhë të parë simbolikën e religjionit edhe tek ne, siç ka ndodhur në përgjithësi tek të gjithë popujt por në veçanti në Ballkan, ndikimet e feve të ndryshme e kanë sjellë këtë ndikim edhe në emërtimet tona, duke pasur parasysh se kufijtë fetarë kanë pasur një shtrirje shumë më të madhe se ato etnike e shtetërore. Nëpërmjet emrave të shenjtorëve të feve përkatëse, u fut në antroponiminë shqiptare një sasi e madhe emrash të huaj. Kuptohet që këto emra janë përvetuar duke i përshtatur ata fonetiki dhe morfologjikisht sipas normave dhe etapave të zhvillimit fonetik të shqipes. Një pjesë e mirë e emrave në vendin tonë kanë ardhur edhe si rezultat i ndikimit të artit dhe letërsisë së huaj. Kështu emra protagonistësh të filmave artistikë, aktorëve, këngëtarëve u bënë emra të preferuar si: *Romeo, Hamlet, Pushkin, Kevin, Riki, Andi*. Në kohën e komunizmit filloi një punë për të eliminuar emrat e huaj. Fjalori i botuar me emra njerëzish përmbante kryesisht emra të burimit shqip ose emra të shqiptarizuar, u jepte mundësi prindërve për të zgjedhur një prej tyre, pavarësisht se edhe këtu ka pasur emra të politizuar të kohës si: *Partizan, Flamur, Komunist, Proletar* etj., që dilnin jashtë natyrës së gjuhës shqipe.

Nëse antroponimia është shkenca që studion emrat vetjakë të njerëzve, toponimia është shkenca që studion emërtimet e objekteve dhe vendeve gjeografike, që kanë një rol të mëvetësishëm në jetën njerëzore në shoqëri, por që në ndryshim nga antroponimet dallohen për jetëgjatësi më të madhe. Duke veçuar me emër të përveçëm një objekt gjeografik shoqëria e diferencon këtë objekt nga objektet e tjera të ngjashme ose të njëjta, duke e transferuar në një orientues të mirëfilltë. Ato ruajnë në vetvete dëshmi të çmuara për kohë të hershme, ndoshta dhe epoka parashkrimore, dhe mbijetojnë edhe mbi gjuhët dhe popujt që i kanë krijuar. Studimi i

toponimisë na sjell të dhëna shumë të çmuara për shumë shkenca të tjera, që i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre specifike informacionin e konservuar në kohë nëpërmjet emërtesave, që vjen nga burime dhe epoka të ndryshme. Kjo e lidh toponiminë me disiplina të ndryshme si historinë e gjuhës, historinë, etnografinë, arkeologjinë, gjeografinë etj.

Toponimia

Edhe pse është bërë mjaft, sot studimet në fushën e onomastikës dhe të toponimisë në nivel rajonal por edhe më gjerë lenë shumë për të dëshiruar. Në disa raste kur janë bërë, në pjesën dërmuese mungon një analizë e plotë gjuhësore e shtrirë në rrafshin sinkronik dhe atë diakronik. Për fat të keq kemi edhe analiza të toponimisë, që jo vetëm janë larg të qenit gjuhësore, por në mjaft raste aspak objektive dhe qesharake, duke u recur të trajtojnë periudha historike të panjohura për ta, që shpeshherë kanë zgjuar debate të kota dhe pa fryt. Në këtë trajtesë do të mundohemi të shtjellojmë një pjesë të tyre, duke e ilustruar atë edhe me fakte historike dhe gjuhësore.

Si në çdo studim dhe aq më shumë në fushën e gjuhësisë sidomos në studimet diakronike të saj, duhet mbajtur parasysh fort një parim bazë që duhet ta ketë kujdes çdo hulumtues, objektiviteti, pasi në të kundërt përfundimet e nxjerra nuk do të jenë koherente dhe brezat që vijnë do qeshin me ne. Nga disa "studiuës" etimologjia e emrave gjeografikë paraqitet si një punë mjaft e lehtë dhe e këndshme, duke vënë në funksion fantazinë naive, sipas përputhjes që mund të ketë forma e jashtme me zberthimin rrokjesor që mund të ketë përkime të ndryshme dhe të rastësishme në shqip. Këto ngjasojnë shpesh me ato të barsoletave të tipit *Amerikë* që në shqip e zberthejmë me *ha merr* dhe *ikë*. Kështu bëhet edhe zberthimi nga autorë, që nuk kanë asnjë lidhje me gjuhësinë, i emërtimeve të tilla si Azi me shqipen *a 'është' zi, Afrikë nga a 'është' frikë, Athinë* zberthehet me shqipen *'e tillë'*. Ose personazhe të antikitetit ku antroponime si *Helena* (bëhet fjalë për Helenën e Trojës) argumentohet me shqipen *'e lëna* (d.m.th. nga mendja). Për këta autorë shqipja ka qenë ajo që është sot pa pësuar asnjë deformim në rrymë të shekujve, siç është problemi i nyjave të parme, evolucioni në sistemin fonetik etj.

Dihet që tek toponimia dhe konkretisht oikonimet janë pjesa që i është nënshtruar më shumë trysnisë së huaj. Këtu, më tepër se kudo gjetkë, kanë vepruar administratat e huaja përkatëse që kanë sunduar, të cilat në mjaft raste kanë bërë përkthimin e oikonimeve në gjuhë të vet. P.sh., referuar burimeve historike kemi pasur përkthim të toponimit nga njëra gjuhë e huaj në tjetër, të emërvendeve sot të banuara krejtësisht nga shqiptarë. Emërtimi i dikurshëm grek i

qytetit *Kefalonia*, nga greqishtja *kefali* 'kokë', me ardhjen e sllavëve është përkthyer në gjuhën e vet *Gllavenicë*, nga trajta sllave bullgare *gllava* 'kokë' për të kaluar më pas në shqip *Ballsh*, nga *ballë*. Po kështu *Sellasfori* i dikurshëm nga greqishtja 'dritëmbajtës' me ardhjen e sllavëve ka marrë trajtën sllave që ruhet edhe sot *Zvezda* nga sllavishtja *zvezda* 'yll', fshat që ndodhet në komunën Pojan të rrethit të Korçës.

MANSAKU, Seit (1982), »Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë«: Studime Filologjike”, Tiranë.

SHKURTAJ, Gjovalin (), »Disa veçori strukturore e semantike të toponimeve të formuara me mjete të shqipes«.

SHKURTAJ, Gjovalin (2001), *Onomastikë dhe etnolinguistikë*. Tiranë.

Përfundime

Kuptueshmëria dhe përthyeshmëria e një pjese të mirë të toponimisë shqiptare, ndoshta në disa raste na afron mundësinë e një studimi të dygjuhësisë popullore. Të qenit e një toponimie me burim të huaj “i tremb” disa studiues, që nuk merren fare me argumentimin e tyre, por shprehin kënaqësinë e zëvendësimit dhe zhdukjes së plotë të tyre. Nuk duhet harruar kurrë se në etimologjinë e toponimisë, krahas vërtetësisë gjeografike kemi edhe atë historike. Burimi i huaj i një toponimie të dhënë nuk parakupton domosdoshmërisht se atje nuk ka pasur shqiptarë, për të dalë më pas në probleme të autoktonisë së popullsisë në fjalë. Nëse një fjalë është e huazuar dhe në të folmen e asaj krahe ku hasim emërtimin e vendit, kjo është e qartë dhe e shpjgueshme. Ose edhe në rastet ku sot nuk e hasim në të folmen sinkronike fjalën e përdorur në toponim, lind nevoja e lëvrimin diakronik të toporrënjes për të arritur në përfundimin e saktë të saj.

Studimet më të thelluara të toponimisë së vjetër, duke depërtuar në historinë e lashtësisë, ndoshta do të na çojë tek emërtesat fillestare e saj, paragreke dhe parasllave, tek substrati i hershëm që ndoshta është edhe “nëna” e shqipes. Vetëm nëpërmjet studimeve të tilla mund të pasurohet historia e gjuhës shqipe duke hedhur dritë mbi hershmërinë historike të gjuhës dhe popullit tonë.

Literatura:

ÇABEJ, Eqrem (1979), »Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore të gjuhës shqipe«: *“Studime Filologjike”*, nr. 3, Tiranë.

ÇABEJ, Eqrem (1958), »Problemi i autoktonisë së shqiptarëve nën dritën e emrave të vendeve«: *“BSHSH”*, Tiranë.

DAKA, Palok (1984), »Rreth antroponimeve të hershme shqiptare«: *“Studime Filologjike”*, nr. 3, Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban (1984), »Rreth emrit të lashtë të popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe«, *“GJJ”*, nr. 1, Tiranë.

ISMAJLI, Rexhep (1979), »Disa çështje të onomastikës mesjetare«. *“OK”*, Prishtinë.

LAFE, Emil (1974), »Toponime latine të shqipes«: *“Kuvendi i studimeve ilire”*. Tiranë.